

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Metodologjia e Auditimit II

M7

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data: 20.10.2018

CONTENT / PËRMBAJTJA

Pjesa	Maksimumi i Dhënë	-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga <u>ShKÇAK-PIKËT E DHËNA</u>
1. Detyra 1	20	
2. Detyra 2	20	
3. Detyra 3	20	
4. Detyra 4	20	
5. Detyra 5	20	
Total	100	

Detyra 1

Grupi Pjeshka (Grupi) është botues i gazetave, revistave akademike dhe librave. Grupi, një njësi ekonomike e listuar, ka një vit financiar që përfundon më 30 prill 2018, dhe firma juaj, Specialisti shpk, është emëruar si auditor i Grupit në Shtator 2017. Specialisti shpk do të auditojë të gjitha kompanitë e Grupit me përjashtim të Oqeani Co, një degë e huaj, që auditohet nga një firmë lokale auditorësh, Lumi Associates. Grupi synon të jetë plotësisht në përputhje me kërkesa e qeverisjes korporative.

Ju jeni menaxher përgjegjës për auditimin e Grupit dhe partneri i angazhimit të auditimit sapo ka dërguar email në vijim tek ju:

Për: Menaxheri i auditimit

Nga: Granit Guri, partner i angazhimit të auditimit

Tema: Planifikimi i Auditimit të Grupit Pjeshka

Përshëndetje,

Unë kam dhënë disa informacione për t'ju ndihmuar në planifikimin e auditimit të Grupit Pjeshka. U takova dje me drejtorin financiar të Grupit për të diskutuar disa aspekte të biznesit të Grupit dhe çështjeve të lidhura me kontabilitetin. Një nga anëtarët e ekipit të auditimit ka kryer tashmë procedura të kufizuara analitike të bazuara në financat e projektuara të Grupit, dhe unë jua kam dhënë rezultatet e kësaj pune. Unë gjithashtu ju kam dhënë një ekstrakt nga komunikimi që morëm nga Legjenda & Co, auditori i mëparshëm i Grupit.

Duke përdorur informacionin e dhënë, unë kërkoj që ju të përgatisni shënimet e informimit që do të përdoren si pjesë e planifikimit të takimit të ekipit të auditimit

Shënimet tuaja të informimit duhet të:

(a)

- i. Vlerësoni rreziqet e auditimit që duhet të merren parasysh gjatë planifikimit të auditimit të pasqyrave financiare të Grupit, dhe **(5 pikë)**
- ii. Identifikoni çështjet të cilave ekipi i auditimit duhet të caset me një shkallë të lartë skepticizmit profesional. **(7 pikë)**

(b) Për të ndihmuar asistentëve të auditimit në kuptimin e strategjisë sonë të auditimit në lidhje me Oqeani Co:

- i. Shpjegoni termin "komponent i rëndësishëm" dhe vlerësoni nëse Oqeani Co është një komponent i rëndësishëm i Grupit, dhe **(4 pikë)**
- ii. Diskutoni natyrën dhe shkallën e përfshirjes që firma jonë duhet të ketë me vlerësimin e rrezikut të auditimit që do të kryhet nga Lumi Associates. **(4 pikë)**

Faleminderit

Informacionet dhe rezultatet e procedurave analitike

Grupi vepron në nivel global, me shitjet që bëhen në mbi 100 vende. Grupi ka 20 filiale që janë fituar gjatë 30 viteve të fundit. Të gjitha kompanitë e Grupit janë të vendosura në të njëjtin vend, me përjashtim të Oqeani Co, një filial i huaj, operacionet e të cilit fokusohen në përkthimin e përmbajtjeve të publikuara në një shumëllojshmëri gjuhësh.

Aktivitetet botuese të Grupit mund të kategorizohen në tre segmente operacionale, secila prej të cilave si njësi gjeneron para për qëllime të rishikimeve të dëmtimeve: gazeta dhe revista, revista akademike dhe libra. Të ardhurat dhe totali i aktiveve për vitin 2018 (te parashikuara) dhe 2017 (aktuale) për Grupin në total dhe për secilin segment janë si vijon:

Segmenti operativ	Viti deri në 30 Prill 2018 Te hyrat e projektuara €milion	Viti deri në 30 Prill 2017 Te hyrat aktuale €milion	Ndryshimi ne te hyra %	Viti deri në 30 Prill 2018 Asetet e projektuara €milion	Viti deri në 30 Prill 2017 Asetet aktuale €milion	Ndryshimi ne asete %
Gazetat dhe revistat	64	67	(4.5)	45	42	7.1
Revista akademike	47	46	2.2	18	15	20
Librat	42	45	(6.7)	32	28	14.3
Totali i Grupit	153	158	(3.2)	95	85	11.8

Gjatë vitit financiar Grupi ka investuar në softuer që shtrihet në të gjitha segmentet operative. Investimi i përgjithshëm, i njohur si një aktiv jo-material, ishte 15 milionë €, prej të cilave 5 milionë € kanë të bëjnë me softuerin e blerë dhe 10 milionë € lidhen me softuerin e zhvilluar nga vete Grupi.

Sipas menaxhmentit, zbatimi i këtij softueri ka çuar tashmë në rritje të konsiderueshme në shitjet e publikimeve digjitale, edhe pse kjo përbën vetëm rreth 20% të të ardhurave të Grupit aktualisht, menaxhimi është i sigurt se shitjet e botimeve digjitale do të rriten shpejt, dhe brenda tre viteve pritet të tejkalojnë shitjet e publikimeve në të gjitha segmentet operative. Duke përdorur këtë justifikim, menaxhmenti nuk e konsideron të nevojshme kryejnë rishikime të dëmtimeve në cilëndo nga tre segmentet operative të këtij viti.

Informacione mbi disa aspekte specifike të operacioneve të Grupit dhe politikat kontabël të Grupit të shoqëruara, dhe informacion në lidhje me Oqeani Co, janë dhënë më poshtë:

Gazetat dhe revistat - të drejtat e botimit

Një pjesë e konsiderueshme e botimeve të gazetës dhe revistës së Grupit mbrohen nga të drejtat e publikimit të cilat mbrojnë të drejtën ekskluzive të Grupit për të publikuar gazetën apo revistën përkatëse për periudha të caktuara. Grupi zotëron më shumë se 200 të drejta botimi, të cilat variojnë në periudhën e ekskluzivitetit nga 5 vjet në 30 vjet. Të drejtat e publikimit njihen si një aktiv jo-material me një vlerë kontabël prej € 7.9 milion. Politika e kontabilitetit të Grupit është për të amortizuar të drejtat e publikimit për një periudhë mesatare prej 25 vjetësh.

Librat - avance për të drejta autoriale

Grupi autorizon autorët për të shkruar libra për të cilët Grupi zotëron të drejtën e autorit. Kur një libër është i porositur, autorit i paguhet një paradhënie, shuma e së ciles varet nga shitjet e pritshme të librit. Politika e kontabilitetit është që të shtyjë koston e avancit deri në botimin e librit, në të cilën pike kostoja fillon të njihet si një shpenzim, i shtrire gjatë një periudhe dhjetëvjeçare. Drejtori i financave të Grupit

nuk ka një justifikim për këtë periudhë dhjetëvjeçare përveçse të jetë 'praktika e industrisë'. Parashikimi total i te drejtave që do të njihet brenda aktiveve afatgjata më 30 prill 2018 është € 3.4 milion.

Oqeani Co

Oqeani Co është e vendosur në Largistani, një vend që ka përjetuar kohët e fundit trazirat politike, duke çuar në paqëndrueshmëri të konsiderueshme monedhën vendase, Lira. Në datën e sotshme, llogaritë e menaxhimit të Oqeani Co njohin aktivet e përgjithshme prej 68 milion Lira, dhe kursi i këmbimit është 4 Lira: 1 €. Gjatë gjashtë muajve të fundit, kursi i këmbimit është luhatur mes 10 Lira: 1 € në 3 Lira: 1 €.

Largistani kërkon përdorimin e Standardeve të SNRF-së dhe për këtë arsye Oqeani Co përgatit pasqyrat financiare duke përdorur SNRF si kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar.

Për të ndihmuar me zhvillimin e kompanive të përkthimit, më 1 maj 2017, Pjeshka Co, kompania prind e Grupit, transferoi një pjesë të softuerit të përkthimit në Oqeani Co. Softueri ishte blerë nga kompania mëmë për € 1.5 milion para disa vitesh dhe para se të transferohej në Oqeani Co, ajo u mbajt në një shume prej € 1 milion, kjo është kostoja e saj pas amortizimit deri më sot. Menjëherë para se të transferohej tek Oqeani Co, softueri u rivlerësua në pasqyrat financiare të kompanisë mëmë në € 5.4 milion, duke qenë kjo vlera në kohën e transferimit të drejtës së vlerësuar. Vlerësimi i vlerës së drejtë është përcaktuar nga menaxhmenti i Grupit, dhe kjo shumë është ende e papaguar nga Oqeani Co.

Komunikimi nga Legjenda & Co

Auditori i mëparshëm i Grupit, Legjenda & Co, thotë në komunikimin e tyre me Specialisti-n:

"Ne kemi vepruar si auditor i Grupit për katër vitet e fundit dhe opinionin ynë i auditimit është modifikuar çdo vit. Megjithatë, ne do të dëshironim të sjellim në vëmendjen tuaj një çështje që ka të bëjë me aranzhimet e qeverisjes korporative të Grupit. Ne konstatuam se në disa raste në vitin e kaluar, ZKF-ja e Grupit fillimisht bllokoi qasjen e firmës sonë në komitetin e auditimit të Grupit, duke e bërë të vështirë për ne që të diskutojmë çështjet në lidhje me auditimin me komitetin. "

Kërkohet:

Përgjigjuni udhëzimeve në emailin e partnerit të angazhimit të auditimit.

(20 pikë)

Zgjidhja e detyrës - 1

Shënime informuese

Për: Granit Guri, Partner i angazhimit të auditimit

Nga: Menaxheri i Auditimit

Tema: Planifikimi i Auditimit të Grupit Pjeshka

Prezantimi

Këto shënime informuese kanë të bëjnë me planifikimin e auditimit të Grupit Pjeshka (Grupi) për vitin që përfundon më 30 prill 2018. Siç kërkohet, shënimet përmbajnë një vlerësim të rreziqeve të auditimit të cilat duhet të merren parasysh në planifikimin e auditimit të Grupit, duke përfshirë një vlerësim fillestar

te fushave specifike ku ekipi i auditimit duhet të ushtrojë skepticizëm profesional. Shënimet gjithashtu vlerësojnë nëse Oqeani Co, degë e huaj e Grupit, është një komponent i rëndësishëm i Grupit. Ne do të punojmë me një auditor të komponentit, Lumi Associates, dhe këto shënime diskutojnë shkallën e përfshirjes që firma jonë duhet të ketë me vlerësimin e rrezikut të auditimit të kryer nga Lumi Associates në Oqeani Co.

(a) (i) dhe (ii) Rreziku i auditimit dhe zbatimi i skepticizmit profesional

Klient i ri i auditimit

Ky është viti i parë që firma jonë ka audituar Grupin. Kjo shkakton rrezikun e zbulimit, pasi firma jonë nuk ka përvojë me klientin, duke e bërë më të vështirë për të zbuluar gabime materiale. Megjithatë, ky rrezik mund të zbutet përmes planifikimit rigoroz të auditimit, duke përfshirë marrjen e një kuptimi të plotë të biznesit të Grupit.

Përveç kësaj, ekziston rreziku që balancat e hapjes dhe informacioni krahasues mund të mos jenë të sakta. Nuk ka arsye për të qenë një rrezik veçanërisht i lartë, pasi opinionet e auditorit të mëparshëm nuk janë modifikuar për katër vitet e fundit.

Megjithatë, për shkak se shifrat e vitit paraprak nuk ishin audituar nga Specialisti, ne duhet të planifikojmë të auditojmë bilanci fillestar me kujdes, në përputhje me ISA510 Angazhimet Fillestare të Auditimit - Balancat Fillestare, për të siguruar që balancat e hapjes dhe informacioni krahasues janë të dy pa gabime materiale.

Presion mbi rezultatet

Grupi është një njësi e listuar, dhe rezultatet e shqyrtimit paraprak analitik tregojnë se ka një reduktim në

të ardhurat totale të Grupit prej 3.2%. Segmenti operativ i botimit të librit ka reduktimin më të ndjeshëm në të hyrat 6.7%. Presioni nga aksionerët për Grupin për të rikthyer një performancë më të mirë krijon një nxitje për paragjykim të menaxhimit, sidomos duke pasur parasysh investimin e rëndësishëm në softuer të ri që është bërë - aksionarët do të duan të shohin një kthim në atë investim. Kjo do të thotë që menaxhmenti mund të përdorë teknikat e menaxhimit të fitimeve ose metoda të tjera të kontabilitetit krijues, për të krijuar një pamje më të shëndetshme të performancës financiare se sa është në të vërtetë rasti. Kjo krijon një rrezik të pandarë të gabimeve materiale, në nivelin e pasqyrave financiare.

Kjo do të thotë që ekipi i auditimit duhet të zbatojë skepticizëm profesional në fushat e auditimit për gjykimin e menaxhmentit, veçanërisht nëse trajtimi kontabël i cili është zbatuar rezulton në përshpejtimin ose mbivlerësim të të ardhurave, ose shtyrja e shpenzimeve.

Segmentet operative

Meqenëse Grupi është një njësi e listuar, do të kërkohet që të japë informacion shpjegues në shënimet e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF 8 Segmentet e Operimit. Ekziston rreziku i auditimit që shplassja mund të jetë e pasaktë ose jo e plotë, ose që nuk pasqyron mënyrën se si informacioni mbi performancën financiare monitorohet brenda vendit nga operatori kryesor, siç kërkohet nga SNRF 8. Për shembull, fakti që dy nga tre segmentet operative të raportuara janë duke treguar një rënie në performancën ndërsa të tjerët tregojnë përmirësim mund të tregojnë pasaktësi në informacion. Përveç kësaj, nëse menaxhmenti është duke monitoruar veçmas performancën e burimeve dixhitale dhe jo-digjitale të të ardhurave, dhe nëse shitjet dixhitale bëhen të rëndësishme, atëherë kjo mund të duhet të shpalojë si një segment i veçantë operativ.

Skepticizmi profesional duhet të zbatohet për auditimin e segmenteve operacionale; për shkak të paragjykimit të menaxhimit, alokimi i të ardhurave, shpenzimet dhe pasuritë midis segmenteve mund të jenë subjekt i manipulimit, për shembull, për të maskuar rënien e performances se librit dhe segmenteve të gazetave dhe revistave. Alokimi përcaktohet nga menaxhmenti, dhe ky gjykim duhet të trajtohet me skepticizëm, sidomos duke pasur parasysh mungesën e mundshme të integritetit të shfaqur nga

ZKF siç tregohet nga komunikimi nga Legjenda & Co.

Programe të zhvilluara brenda entitetit

Pasqyrat financiare të grupit njohin 10 milionë € që janë kapitalizuar në lidhje me zhvillimet e brendshme të softuerite. Kjo është e barabartë me 10.5% të aktiveve të Grupit dhe shuma është për këtë arsye material për pasqyrat financiare.

Një rrezik auditimi lind në atë që kërkesat e SNK 38 Mjetet e paprekshme mund të mos jenë ndjekur. Kostot e zhvillimit mund të kapitalizohen vetëm nëse plotësojnë kriteret e kapitalizimit, duke përfshirë edhe atë se përfitimi i ardhshëm ekonomik mund të demonstrohet dhe se është realizuar perfundimi teknik dhe komercial i asetit. Nëse këto kritere nuk janë përmbushur, atëherë kostot e zhvillimit duhet të shpenzohen. Përveç kësaj, Grupi mund të mos beje dallim në mënyrë të përshtatshme midis kostove të kërkimit dhe zhvillimit. Nëse kostot e hulumtimit janë përfshirë në shumën e kapitalizuar atëherë ajo është e ekzagjeruar, sepse shpenzimet e hulumtimit duhet të jenë gjithmonë të shpenzuara.

Kjo është një fushë ku duhet të zbatohet skepticizmi profesional. Ekziston rreziku që fitimi të ekzagjerohet nga një shumë materiale nëse trajtimi kontabël është i pasaktë.

Dëmtim

Menaxhmenti nuk planifikon të testojë njësitë gjeneruese të mjeteve monetare për demtim, duke shkaktuar një rrezik të rëndësishëm auditimi.

Pavarësisht nga treguesit e zhvlerësimit, emri i mirë duhet të testohet për zhvlerësim çdo vit sipas SNK 38 dhe pasi Grupi ka mbi 20 filiale.

Përveç kësaj, ulja e të ardhurave për Grupin si tërësi, si dhe për gazetatat, revistat dhe librat si segmente operative në mënyrë specifike, është një tregues i dëmtimeve të mundshme. Kjo duhet të shkaktojë një rishikim të dëmtimit edhe nëse nuk ka emër të mirë për njësitë gjeneruese të mjeteve monetare. Arsyeja e menaxhmentit për mos kryerjen e një rishikimi dëmtimi është tërësisht i papërshtatshëm dhe në qoftë se nuk bëhet një rishikim i dëmtimeve dhe asnjë humbje e nevojshme nuk njihet, atëherë fitimi dhe pasuritë do të mbivlerësohen, ndoshta me një shumë materiale.

Përsëri, kjo është një fushë ku ekipi i auditimit do të duhet të aplikojë skepticizëm profesional dhe të sfidojë supozimin e menaxhimit se një rishikim i dëmtimit nuk është i nevojshëm. Ngurrimi i menaxhmentit për të kryer një rishikim të dëmtimit mund të jetë për shkak të paragjykimit të menaxhimit dhe presionit për të kthyer një fitim të shëndetshëm për aksionarët.

Të drejtat e botimit

Të drejtat e publikimit njihen si një aktiv jo-material me një vlerë kontabël prej € 7.9 milion, që përfaqëson 8,3% të totalit të aktiveve. Kjo është materiale për pasqyrat financiare. Është e përshtatshme që të drejtat e publikimit të amortizohen, pasi ato kanë një jetë të caktuar. Megjithatë, periodha gjatë së cilës ata amortizohen mund të mos jetë e përshtatshme. Politika e kontabilitetit të grupit është amortizimi mbi një mesatare prej 25 vjetësh, por periodha aktuale në të cilën lidhen të drejtat varion nga pesë në 30 vjet. Prandaj, ndërkohë që mund të jetë e përshtatshme për të përdorur një mesatare për bazën e një politike kontabël, kjo do të thotë disa të drejta janë duke u amortizuar për një periudhë shumë të gjatë, duke zmadhuar pasuritë e paprekshme dhe duke nënvlerësuar shpenzimet.

Menaxhmenti mund të përdorë këtë periudhë mesatare 25 vjeçare si një mënyrë për të zbutur fitimet dhe menaxhimin e të ardhurave. Politika e kontabilitetit mund të mos jetë e përshtatshme dhe ekipi i auditimit duhet të jetë skeptik në lidhje me përshtatshmërinë e politikës.

Avancet për autorët

Paradhëniet e të ardhurave të njohura brenda aktiveve qarkulluese arrijnë në € 3.4mil, që është 3.6% e totalit të aktiveve.

Shtyrja e kostos, në mënyrë efektive duke e trajtuar atë si parapagim, duket të jetë e përshtatshme. Megjithatë, politika kontabël e Grupit duhet të sfidohet nga ekipi i auditimit. Lirimi i kostos për një periudhë dhjetëvjeçare duket se nuk ka ndonjë justifikim të përshtatshëm dhe duket të jetë mjaft e thjeshtë. Ndërsa praktika e industrisë mund të përdoret për zhvillimin e politikave kontabël, Grupi duhet të konsiderojë periudhën specifike të amortizimit që lidhet me publikimet e saj dhe nuk i formësojnë thjesht politikat e saj të kontabilitetit mbi veprimet e konkurrentëve të saj në treg, të cilët mund të kenë lloje të ndryshme botimesh që sigurojnë përfitime ekonomike gjatë një periudhe të ndryshme. Me sa duket disa libra të publikuara nga Grupi do të kenë një jetë shumë më të shkurtër se dhjetë vjet, në të cilin rast pagesa e parapagimit duhet të shpërndahet për një periudhë më të shkurtër. Ngjashëm me pikën e ngritur më parë në lidhje me trajtimin kontabël të të drejtave të botimit, menaxhmenti mund të përdorë këtë periudhë mesatare dhjetëvjeçare si një mënyrë për të zbutur fitimet dhe menaxhimin e të ardhurave. Përsëri, politika e kontabilitetit mund të mos jetë e përshtatshme dhe ekipi i auditimit duhet të jetë skeptik në lidhje me përshtatshmërinë e politikës.

Oqeani Co

Për t'u konsoliduar në Grup, pasqyrat financiare të Oqeani Co do të duhet të rishikohen nga valuta lokale e saj, Lira, në €, në përputhje me SNK 21 Efektet e ndryshimeve në kurset e këmbimit valutor. SNK 21 kërkon që aktivet dhe detyrimet janë përkthyer në kursin përfundimtar të këmbimit në datën e raportimit, ndërsa të ardhurat dhe shpenzimet janë përkthyer me kursin e këmbimit në datën e transaksioneve. Fakti që monedha ka qenë e paqëndrueshme gjatë gjashtë muajve të fundit dhe mund të mbetet e paqëndrueshme gjatë pjesës tjetër të vitit do të thotë se ri-përkthimi i të ardhurave dhe shpenzimeve është problematik; duke shkaktuar kështu rrezikun e gabimeve materiale Oqeani Co është një komponent i rëndësishëm i Grupit

Transferimi i softuerit

Transferimi i softuerit shkakton disa rreziqe të auditimit. Së pari, ekziston rreziku që softueri të mbivlerësohet kur ai u transferua nga Pjeshka Co në Oqeani Co. Vlera e drejtë e cila u njoh në llogaritë e kompanise mëmë menjëherë para transferimit të aktivitetit është përcaktuar nga menaxhmenti i Grupit,

ndërsa rivlerësimi lejohet nga SNK 38, ku ekziston një treg aktiv për aktivin, kjo vlerë e drejtë mund të jetë e papërshtatshme. Në mungesë të një aktiviteti tregu, nuk ka gjasa që rivlerësimi të ishte njohur fare. Ka një ndryshim të rëndësishëm në mes të vleres kontabël të softuerit dhe vleres së drejtë të përcaktuar nga menaxhmenti, € 1 milion dhe € 5.4 milion respektivisht, duke shkaktuar një rivlerësim prej € 4.4 milion që u njoh nga Pjeshka Co menjëherë para transferimit. Rreziku auditimi është që në shoqërinë mëmë, rivlerësimi nuk duhet të ishte njohur, ose nëse rivlerësimi është i përshtatshëm, shuma e njohur është bazuar në një vlerë të papërshtatshme. Në pasqyrat financiare individuale të Oqeani Co, aktivi mund të ekzagjerohet në vlerë. Çdo mbivlerësim i aktivit ka implikime për pagesat pasuese të amortizimit, të cilat

gjithashtu do të ekzagjerohen në pasqyrat financiare të Oqeani Co.

Ekipi i auditimit duhet të trajtojë këtë çështje me skepticizëm të duhur profesional - rivlerësimi i softuerit do duhet të justifikohet nga menaxhimi pasi që mund të jetë një mekanizëm që përdoret nga menaxhmenti i Grupit për të rritur aktivet e Oqeani Co dhe Grupit në tërësi. Ekipi i auditimit duhet gjithashtu të kundërshtojë pohimin e bërë nga menaxhmenti se nuk ekziston një treg mjaft aktiv për të mundësuar përcaktimin e një vlere të drejtë dhe të besueshme reale për softuerin.

Në nivel Grupi, transferimi është një transaksion intern dhe pasqyrat financiare të konsoliduara duhet të përgatiten sikur transaksioni të mos kishte ndodhur. Ky është një rrezik shtesë dhe i veçantë i auditimit nga rreziku që vlerësimi i pasurisë nuk është i përshtatshëm. Ekziston rreziku i auditimit nëse eliminimi i transaksionit ndërkompanik nuk kryhet si pjesë e procesit të konsolidimit. Përshtatjet duhet të bëhen për të anuluar të pagueshmet ndër-kompanike dhe të arkëtueshme respektive prej € 5.4 milion.

Rregullimet e qeverisjes së korporatave

ZKF-ja e Grupit që bllokoi qasjen në komitetin e auditimit nuk është e pranueshme. Parimet e qeverisjes së korporatave, si dhe SNA260 Komunikimi me ata që janë të ngarkuar me qeverisje, kërkojnë që auditori i jashtëm të ketë të pakufizuar dhe efektiv komunikimin me komitetin e auditimit, dhe ZKF nuk duhet të ndërhyjë në këto komunikime. Kjo situatë mund të tregojë se ZKF ka diçka për të fshehur dhe se mjedisi i kontrollit brenda grupit nuk është i fortë dhe ky rrezik është shtuar nga pikat e ngritura në lidhje me paragjykimet e menaxhmentit. Në përputhje me udhëzimet e qeverisjes korporative, Komiteti i auditimit

duhet të vlerësojë efektivitetin e procesit të auditimit të jashtëm dhe një pjesë kyçe e kësaj ka të ngjarë të bëhet nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë që ka auditori dhe komiteti i auditimit. Duket sikur ZKF i mungon integriteti ose ndoshta nuk kupton parimet relevante të qeverisjes së korporatave.

Më tej sipas SNA210 Kushtet të angazhimit të auditimit, sigurohet qasja e pakufizuar e personave brenda njësisë si një nga parakushtet për auditimin. Si e tillë, ZKF është potencialisht duke imponuar një kufizim në fushëveprimin e auditimit duke mos lehtësuar komunikimin e pakufizuar dhe efektiv me Komitetin e auditimit.

Të gjitha këto çështje rrisin rrezikun e auditimit dhe nevojën për afrimin e auditimit me skepticizmin profesional.

(b) (i) Vlerësimi nëse Oqeani Co është një komponent i rëndësishëm i Grupit?

Konsiderata të Veçanta të SNA600 - Auditimet e Pasqyrave Financiare të Grupit (duke përfshirë punën e Auditorëve të Komponentëve) kërkojnë që auditori i grupit të përcaktojë nëse një komponent është një komponent i rëndësishëm.

SNA600 përcakton një komponent të rëndësishëm si një komponent i identifikuar nga ekipi i angazhimit në grup, i cili është me rëndësi individuale financiare për grupin, ose që, për shkak të

natyrës apo rrethanave të tij specifike, përfshinë rreziqe të rëndësishme të gabimeve materiale të pasqyrave financiare të grupit.

SNA600 sugjeron që kriteret si fitimi dhe asetet duhet të vlerësohen kur përcaktohet rëndësia, por ajo nuk kërkon që të përdoret një prag specifik. Standardi sugjeron që 15% mund të jetë një prag i përshtatshëm për përcaktimin e domethënies.

Asetet e përgjithshme të Oqeani Co janë 68 milion Lira dhe nëse rikthehen duke përdorur kursin aktual të këmbimit prej 4 Lira: 1 €, asetet janë 17 milionë €. Kjo përfaqëson 17.9 për qind të aktiveve të Grupit prandaj bazuar në informacionin në datën e sotme, Oqeani Co është një komponent i rëndësishëm i Grupit.

Është e rëndësishme të theksohet se duke pasur parasysh luhatshmërinë e monedhës Lira, vlera e filialit mund të ndryshojë nga data e raportimit. Megjithatë, Oqeani Co mund të jetë i rëndësishëm për shkak të specifikave ose rrethanave, duke qenë vetëm degë e jashtme e Grupit, e cila sjell rreziqe specifike për gabime materiale siç përshkruhet më herët në këto shënime informuese. Mund të ketë gjithashtu çështje rregullative ose ekonomike specifike për kompaninë, sidomos për shkak të vështirësive politike në juridiksionin e saj, të cilat gjithashtu ndikojnë në Grupin dhe krijojnë rreziqe. Prandaj pavarësisht nga madhësia e saj monetare, ka gjasa që Oqeani Co të konsiderohet të jetë një komponent i rëndësishëm i Grupit

(ii) Shtrirja e përfshirjes që firma jonë duhet të ketë me punën e Lumi Associates

Kur punoni me një auditor komponenti, ekipi i angazhimit në grup duhet të marrë një kuptim mbi një numër të çështjeve siç kërkohet nga SNA600. Këto çështje përfshijnë kompetencën e auditorit, kornizën etike relevante për auditimin e Grupit dhe se është i pavarur, si dhe mjedisi rregullator në të cilin vepron auditori i komponentit. Shtrirja e përfshirjes që firma jonë do të ketë me Lumi Associates varet nga një masë në vlerësimin e këtyre çështjeve. Nëse ka shqetësime mbi kompetencën, pavarësinë ose zellin e Lumi Associates ose juridiksionin në të cilin ata veprojnë, niveli i përfshirjes me punën e tyre duhet të jetë rritur në përgjigje.

Sipas SNA600, nëse një auditor komponenti kryen një auditim të informacionit financiar të një komponenti të rëndësishëm, ekipi i angazhimit të grupit kërkohet të përfshihet në vlerësimin e rrezikut të auditorit të komponentit për të identifikuar rreziqet e rëndësishme të gabimeve materiale të pasqyrave financiare të grupit. Natyra, koha dhe masa e përfshirjes përcatohen nga kuptimi i ekipit të angazhimit të grupit të auditorit të komponentit, por së paku duhet të përfshijë në vijim:

- Diskutimi me auditorin komponent ose menaxhimin e komponentëve aktivitetet e biznesit të komponentit të cilat janë të rëndësishme për grupin;
- Duke diskutuar me auditorin e komponentit ndjeshmërinë e komponentit ndaj gabimeve materiale për shkak të mashtrimit apo gabimit;
- Shqyrtimi i dokumentacionit të rreziqeve të identifikuar të rëndësishme të gabimeve materiale në pasqyrat financiare të grupit. Dokumentacioni i tillë mund të marrë formën e një memorandumit i cili reflekton konstatimin e auditorit të komponentit në lidhje me rreziqet e identifikuar;
- Vlerësimi i komunikimit të auditorit të komponentit për çështjet që kanë të bëjnë me auditimin e grupit dhe të diskutojnë çfarëdo çështje të rëndësishme që del nga ai vlerësim me auditorin e komponentit;
- Përcaktimi nëse është e nevojshme të shqyrtohen pjesët tjera relevante të dokumentacionit të auditimit të auditorit të komponentit.

Ekipi i auditimit të grupit mund të ketë nevojë të përfshihet më tej në auditimin e komponentit ku rreziqet e rëndësishme të gabimeve materiale të pasqyrave financiare të Grupit janë identifikuar në një komponent.

Detyra 2

(a) Ju jeni një menaxher i auditimit në Floriri & Co, një firmë e auditimit e cila ofron një gamë të Shërbimeve të sigurisë. Ju jeni përgjegjës për auditimin e Drini Co, një kompani e cila siguron rreth 10% e të ardhurave të firmës suaj çdo vit. Drejtori i financave i Drini Co kohët e fundit ju ka kontaktuar

për të siguruar informacion mbi një kompani tjetër, Vjosa Co, e cila kërkon të emërojë një ofrues të shërbimeve të sigurise. Një ekstrakt nga e-maili te cilin drejtori financiar i Drini Co ju ka dërguar është treguar më poshtë:

"Një nga miqtë e mi, Jon Adriatiku, është drejtor menaxhues i Vjosa Co, një kompani e vogël që po kërkon te zgjerohet në vitet e ardhshme. Unë e di që Jon Adriatiku iu është drejtuar bankës së kompanisë për financim prej 6 milionë € për të financuar zgjerimin. Për të mbështetur këtë kërkesë për kredi, Jon Adriatiku duhet të emërojë një firmë për të siguruar rishikimin me siguri të kufizuar të pasqyrave financiare të kompanisë. Ai gjithashtu do të donte që firma e caktuar të siguronte planifikimin tatimor dhe përgatitjen e llogarive të kompanisë dhe tatimeve të tij personale për t'u dorëzuar në autoritetet tatimore. Unë kam kërkuar nga Jon Adriatiku të të kontaktojë, dhe shpresoj se Floriri & Co do të jetë në gjendje t'i ofrojë këto shërbimet për Vjosa Co për një tarifë të ulët. Nëse pagesa që sugjeroni është shumë e lartë dhe e papranueshme për Jon Adriatiku, atëherë do ju rekomandojmë që Jon Adriatiku t'i afrohet Lire-Mire & Co në vend jush, dhe unë do të konsideroj gjithashtu emërimin e Lire-Mire & Co për të të siguruar auditimin e Drini Co "

Lire-Mire & Co është një firmë e auditimit që ka një zyrë në të njëjtin qytet si Floriri & Co.

Ju keni bërë disa kërkime për Vjosa Co dhe Jon Adriatiku dhe keni konfirmuar se kompania është mjaftueshem e vogël për t'u përjashtuar nga auditimi. Kompania është e zotëruar nga pronari, me familjen Shkambi që zotëron 90% të aksioneve. Jon Adriatiku është drejtor dhe aksionar i tre kompanive të tjera. Një artikull në një gazetë nga disa vjet më parë për Jon Adriatikon tregoi se një nga kompanitë e tij ishte gjobitur një herë për shkelje të ligjit te punësimit dhe se ai kishte përdorur para nga një prej planeve të pensioneve të kompanisë për të ngritur një biznes jashtë vendit, duke emëruar djalin e tij si drejtor menaxhues te atij biznesi.

Kërkohet:

Në lidhje me pranimin potencial të Floriri & Co nga Vjosa Co si klient i firmës:

- i. Shpjegoni çështjet etike dhe çështje të tjera që duhet të merren parasysh; dhe
- ii. Shpjegoni rëndësinë e ushtrimit te kujdesit të duhur ndaj klientit dhe rekomandoni informacionin që duhet të merren. **(12 pikë)**

(b) Floriri & Co ka rënë dakord të kryejë një angazhim sigurie për Drini Co; angazhimi do të jetë një përmbledhje e informacione të ardhshme financiare që nevojiten për të mbështetur aplikimin per mbitërheqje të kompanisë. Drini Co kishte vitin financiar qe përfundoi më 30 shtator 2017, dhe një opinion i pamodifikuar është lëshuar për këto pasqyra financiare muajin e kaluar. Partneri i Floriri & Co përgjegjës për etikën ka rënë dakord që çdo kërcënim ndaj objektivitetit të zvogëlohet në një nivel të pranueshëm nëpërmjet përdorimit të një ekipi të ndarë nga ekipi i auditimit.

Parashikimi i fitimit operativ për dy vitet deri më 31 mars 2020 i përgatitur nga një anëtar i ekipit të kontabilitetit te Drini Co është treguar më poshtë, së bashku me disa shënime shoqëruese.

	Shënim	Gjashtë muaj deri në 30 Shtator 2018 € '000	Gjashtë muaj deri në 31 Mars 2019 € '000	Gjashtë muaj deri në 30 Shtator 2019 € '000	Gjashtë muaj deri në 31 Mars 2020 € '000
Të hyrat	1	12,800	16,900	13,700	18,900

Fitimi bruto%		34%	45%	36%	46%
Shpenzimet operative:					
Shpenzimet e stafit		(2,800)	(2,900)	(2,800)	(2,900)
Shpenzimet e projektimit	2	(1,200)	(1,200)	(1,250)	(1,250)
Marketingu		(900)	(1,000)	(1,100)	(1,100)
Interesi mbi mbitërheqjen	3	(25)	(10)		
Shpenzime të tjera	4	(3,840)	(5,070)	(4,110)	(5,670)
Fitimi operativ		4,035	6,720	4,440	7,980

1. Drini Co është një prodhues i kartolinave dhe dhuratave, kërkesa për të cilat është me natyrë sezonale.
2. Shpenzimet e projektimit janë kryesisht shpenzimet e listës së pagave të stafit që punojnë në ekipin e dizajnit të kompanisë dhe kostot lidhen për hartimin dhe zhvillimin e produkteve të reja.
3. Drini Co ka rënë dakord me bankën e saj për të mbyllur mbitërheqjen e saj deri më 1 shtator 2019, dhe ekipi drejtues beson se pas asaj kohe kompania nuk do të ketë nevojë për një mbitërheqje.
4. "Shpenzimet e tjera" llogariten bazuar në 30% të të ardhurave të parashikuara për periudhën gjashtëmujore.

Kërkohe:

Rekomandoni procedurat e ekzaminimit të cilat duhet të përdoren në shqyrtimin e parashikimit të fitimit.

(8 pikë)

[Total: 20 pikë]

Zgjidhja e detyrës - 2

(a) (i) Çështje etike dhe çështje të tjera që duhet të merren parasysh përpara pranimit të Vjosa Co si klient i firmës

Kërkesat dhe udhëzimet që lidhen me pranimin dhe vazhdimin e marrëdhënieve me klientin përmbahen në SNKC 1 Kontrolli i cliesise për firmat që kryejnë auditime dhe rishikime të pasqyrave financiare

Kërkesat themelore janë që një firmë duhet të marrë parasysh:

- Kompetencën e saj për të kryer angazhimin dhe nëse firma ka aftësitë, duke përfshirë kohën dhe burimet për ta bërë këtë,
- Nëse kërkesat përkatëse etike mund të përmbushen, dhe
- Integriteti i klientit dhe nëse ka informata që do ta çonin në përfundimin se klienti nuk ka integritet.

Kompetenca dhe burimet

Duke parë në çdo konsideratë nga ana e tij, nuk duket se ka arsye pse Floriri & Co nuk do të kishte kompetencën për të kryer angazhimin, i cili është një rishikim i sigurisë së kufizuar të pasqyrave financiare historike. Duke qenë një firmë e Kontabilistëve të certifikuar, e cila ofron shërbime të sigurimit të tilla si auditimi i Drini Co, do të thotë se firma ka njohuri dhe përvojë relevante për të kryer një rishikim të sigurisë së kufizuar me cilësi të lartë.

Megjithatë, presioni për të kryer auditimin për një tarifë të ulët mund të ndikojë në aftësinë e Floriri & Co për të kryer me një cilësi të lartë rishikimin në qoftë se burimet e pamjaftueshme janë vënë në dispozicion, duke pasur parasysh kufizimin e mundshëm të tarifës që mundet të ngarkohen për të ofruar shërbimin. SNKC 1 gjithashtu përmend se kur klienti është agresiv në lidhje me mbajtjen sa më të ulët të mundshme të pagesave të firmës, kjo mund të tregojë mungesën e integritetit të klientit.

Çështje etike

Në aspektin e etikës ka disa çështje që duhen marrë parasysh. Së pari, duket se Drini Co po bën presion mbi Floriri & Co për të pranuar angazhimin. Drini Co është një klient relativisht i rëndësishëm i Floriri & Co, duke siguruar 10% të të hyrave vjetore të firmës dhe ekziston një kërcënim në atë që Drini Co ka kërcënuar të shkojë në një tjetër ofrues të auditimit nëse Floriri & Co nuk pranon Vjosa Co si një klient dhe kryen punën për një tarifë të ulët. Kjo gjithashtu mund të perceptohet si një kërcënim me interes vetjak në atë që Floriri & Co ka një interes financiar për të mbajtur një marrëdhënie të mirë me Drini Co.

Një çështje tjetër etike lind nga sugjerimi që Floriri & Co duhet të ofrojë këshilla për planifikimin e taksave për Vjosa Co dhe përgatitjen e deklaratave të saj tatimore. Kjo do të shkaktonte një kërcënim të vetë-rishikimit për shkak se Floriri & Co do të kishte disa të dhëna për shifrat e taksave të cilat janë pjesë e pasqyrave financiare të cilat pastaj do t'i nënshtrohen shqyrtimit të sigurisë së kufizuar.

Sigurimi i këshillave të planifikimit tatimor gjithashtu mund të shihet si veprim në emër të menaxhmentit, duke dëmtuar më tej objektivitetin.

Floriri & Co duhet të marrë parasysh nëse masat mbrojtëse mund të përdoren për të zvogëluar çdo kërcënim etik në një nivel të pranueshëm, për shembull, nëpërmjet përdorimit të ekipeve të veçanta për të siguruar rishikimin e sigurisë së kufizuar dhe shërbimet e taksave dhe duke pasur një partner të pavarur të dytë për të rishikuar punën e kryer. Nëse masat mbrojtëse nuk i zvogëlojnë kërcënimet në nivelin e pranueshëm, atëherë shërbimi tatimor nuk duhet të kryhet përveç rishikimit të sigurisë së kufizuar.

Integriteti i klientit

Përgatitja e llogaritjeve të taksave personale të Jon Adriatikut është më pak çështje etike sa i përket objektivitetit pasi nuk pasqyrohet në pasqyrat financiare.

Integriteti i Jon Adriatikut do të duhet të vlerësohet me kujdes. Nuk ka asgjë të keqe me atë që ka interes në disa kompani, megjithëse duhet të merren informacione për secilën nga këto. Çështjet kyçe me integritetin lidhen me shkeljen e ligjit të punës dhe marrjen e parave nga një plan i pensioneve të kompanisë për të ngritur një biznes që menaxhohet nga djali i tij. Shkelja e ligjit të punës tregon se Jon Adriatiku ka një reputacion të dyshimtë dhe ndoshta që ai ka qenë i përfshirë në veprimtari kriminale, në varësi të asaj që ligjet janë shkelur, dhe seriozitetin e mospërputhjes. Informacioni vjen nga një artikull gazete, prandaj mund të mos jetë shumë i besueshëm dhe mund të mos jetë edhe i vërtetë, dhe më shumë informacion do të duhet të kërkohet për këtë çështje.

Marrja e parave nga plani i pensioneve të kompanisë mund të jetë një shkelje e rregullave përkatëse, dhe kjo do të duket se u bë për të mirën e djalit të tij. Fakti që ky biznes ndodhet në një vend të huaj mund të nënkuptojë gjithashtu se ka diçka më shumë për shembull, mund të jetë një marrëveshje për të lehtësuar pastrimin e parave.

Floriri & Co duhet të marrë informacion të mjaftueshëm për të vlerësuar me kujdes përshtatshmërinë e pranimit të Vjosa Co si klient, dhe ata duhet të dokumentojnë vendimin e pranimit në përputhje me SNKC 1.

ii) Rëndësia e marrjes së kujdesit të duhur të klientit dhe informacionit që duhet të merret gjatë ushtrimit të kujdesit të duhur ndaj klientit, është e nevojshme si pjesë e rregullores për pastrim të parave, të cilën të gjitha firmat e auditimit duhet të kenë në pranimin e klientëve të rinj. Ajo i referohet marrjes së informacionit nga firma për të qenë në gjendje të identifikojë se kush është klienti i ardhshëm dhe të verifikojë identitetin duke iu referuar materialit burimor të pavarur dhe të besueshëm. Kjo është një pjesë e rëndësishme e vlerësimit të rrezikut kur merr një klient të ri dhe i lejon firmës të kuptojë jo vetëm identitetin e klientit të ardhshëm, por edhe natyrën e biznesit dhe burimin e fondeve të tij.

Në mënyrë të veçantë, firma duhet të trajtojë si pjesë e hulumtimit të duhur të klientit:

- Identifikimin e klientit dhe verifikimin e identitetit të tij duke përdorur dokumente, të dhëna ose informacione të marra nga një sistem i besueshëm dhe burim i pavarur.
- Konfirmimin e identitetit të të gjithë aksionarëve, duke përfshirë edhe anëtarët e veçantë të familjes të cilët në mënyrë kolektive kanë 90% të aksioneve të kapitalit aksionar të shoqërisë dhe aksionarin tjetër që zotëron 10% të mbetur.
- Identifikimin e çdo pronari përfitues i cili nuk është klienti. Ky është individ (ose individë) prapa klientit që në fund të fundit posedojnë ose kontrollojnë klientin ose në emër të të cilit kryhet transaksioni ose aktiviteti.
- Kur krijohet një marrëdhënie biznesi, duhet kuptuar qëllimin dhe natyrën e synuar të marrëdhënies, për shembull, detajet e biznesit të klientit ose burimi i fondeve.

Bizneset gjithashtu duhet të kryejnë monitorim të vazhdueshëm për të identifikuar transaksione të mëdha, të pazakonta ose të dyshimta si pjesë e Kujdesit të duhur.

Të gjitha dokumentet e marra për qëllime të kryerjes së kontrolleve të Kujdesit të duhur duhet të mbahen për një minimum prej pesë vjetësh nga fundi i marrëdhënies afariste.

Në këtë skenar, informacioni që duhet të merret përfshinë:

- Për të konfirmuar identitetin e Jon Adriatikut, dëshmi fotografike, për shembull pasaporta e tij, duhet të kopjohen, së bashku me mjete të tjera të identifikimit që tregojnë adresën e tij, për shembull, faturat e fundit të shërbimeve apo pasqyrat e bankes.
- Në lidhje me Vjosa Co, duhet të shihet certifikata e themelimit të kompanisë, për të konfirmuar statusin e saj ligjor dhe data dhe vendi i themelimit.

- Kërkohet një kërkim i kompanive (ose ekuivalenti) në Vjosa Co, kjo do të konfirmojë ekzistencën e kompanisë, aksionerët dhe drejtorët dhe do të ofrojë disa informacione financiare. Kjo do të konfirmojë se Shkëmbi është 'pronari përfitues' i entitetit - dmth se ai është personi i cili zotëron ose kontrollon, drejtpërdrejt ose tërthorazi, më shumë se 25% të aksioneve ose të drejtave të votës ose që në mënyrë tjetër ushtron kontroll mbi drejtorët.
- Identiteti i kompanive të tjera të kontrolluara nga Jon Adriatiku, për të konfirmuar ekzistencën e tyre dhe natyrën e marrëdhënies me Vjosa Co.
- Pasqyrat e fundit financiare të Vjosa Co, dhe kompanive tjera në të cilat Jon Adriatiku ka një interes duhet të rishikohen. Kjo do të ndihmojë Floriri & Co për të kuptuar bizneset dhe marrëdhëniet e tyre me njëri-tjetrin, identifikimin e burimeve të të ardhurave dhe nëse ka transaksione të rëndësishme midis kompanive.
- Identifikimi i burimit të financimit për kompaninë, nëse ka kredi bankare ose ofruesit e tjerë të financave
- Ndonëse nuk është pjesë e qartë e konfirmimit të identitetit të Jonit apo kompanive të tij, Floriri & Co do të kishte nevojë të marrë informacion të mëtejshëm rreth shkëlqes së ligjit të punësimit dhe të konfirmojë faktet që rrethojnë situatën.

Aktualisht, informacioni i vetëm në dispozicion është nga një artikull në gazetë dhe kjo nuk mund të jetë një burim i besueshëm.

(b) Procedurat mbi parashikimin e fitimit operativ të Drini Co

Procedurat e përgjithshme:

- Vlerësoni kompetencën e përgatitësit të parashikimit të fitimit operativ
- Të arrihet një mirëkuptim lidhur me procedurat dhe kontrollet që janë ndjekur në përgatitjen e parashikimit, për shembull, parashikimi është miratuar nga një anëtar i lartë i ekipit të kontabilitetit të kompanisë.
- Konfirmoni që politikat kontabël të aplikuara në pasqyrat financiare të Drini Co janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme në përgatitjen e parashikimit të fitimit operativ.
- Konfirmoni që supozimet që mbështesin parashikimin janë në përputhje me njohuritë e biznesit të përfituar nga kryerja e auditimit të kompanisë, për shembull, sezonaliteti i shitjeve mund të konfirmohet duke shikuar provat e marra në auditimin e të ardhurave.
- Rikalkuloni parashikimet për të siguruar që janë aritmetikisht të saktë.

Procedurat specifike:

- Pyetni nëse një parashikim më i detajuar i fitimit është i disponueshëm ose kërkoni nga menaxhmenti që të përgatisë një, për shembull, duke dhënë detaje nga kostoja e shitjeve dhe shpenzimet e tjera. Përveç kësaj, kërkoni një pasqyre parashikuese të gjendjes financiare dhe pasqyren e rrjedhës së parave të gatshme.
- Kërkesa që menaxhmenti të përgatisë një parashikim të fitimit në të njëjtin format si pasqyrat financiare të audituara dhe në përputhje me Standardet e SNRF-së, dmth. kostoja e interesit duhet të tregohet poshtë vijës së fitimit operativ.
- Merrni koston e shitjeve për secilën periudhë gjashtëmujore, rillogaritni shifrat e fitimit bruto të dhëna në parashikim. Krahasoni këtë me kufijtë e fitimit bruto në pasqyrat financiare të audituara në vitin paraprak dhe hetoni ndonjë anomali.
- Bëni një analizë të përbërësve të koston së shitjeve dhe shpenzimeve të tjera, për çdo kategori të rëndësishme e shpenzimeve.

- Duke u bazuar në sa më sipër, vlerësoni nëse ka kategori të munguara të shpenzimeve të cilat nuk janë përfshirë në parashikimi, p.sh. nuk ka zhvlerësim të përfshirë në parashikim.
- Për të ardhurat, te cilat parashikohen të rriten me një sasi të konsiderueshme (p.sh. rritja prej 11.8% krahasuar gjashtë muajt e fundit 31 mars 2019 dhe 31 mars 2020), mendoni nëse parashikimi duket tepër optimist. Për shembull, nuk ka një rritje korresponduese në kostot e marketingut për të mbështetur parashikimin e rritjes së të ardhurave.
- Krahasoni të ardhurat në parashikimin e vitit deri më 30 shtator 2019 me të hyrat nga pasqyrat financiare të audituara të viteve të mëparshme.
- Hetoni çdo tendencë të pazakontë përmes diskutimit me menaxhmentin.
- Rishikoni çdo plan marketingu dhe diskutoni me një anëtar të lartë të duhur të stafit, për shembull, drejtorin e shitjes. Kerkoni arsyetimin për parashikimin e një rritjeje të konsiderueshme të të ardhurave, për shembull, mund të ketë plane për të futur linja të reja të prodhimit. Konsideroni këtë në dritën e faktit se kostoja e projektimit dhe marketingu nuk parashikohet të rritet me një rritje të konsiderueshme.
- Rishikimi i kostove të projektimit pasi ato duket të jenë mjaft statike me vetëm një rritje të vogël për të arritur një rritje shumë më të madhe në të ardhura. Diskutoni me menaxhmentin dhe vlerësoni nëse një rritje e tillë e të ardhurave mund të arrihet me një rritje të tillë të vogël në kostot e projektimit.
- Konfirmoni dokumentacionin mbështetës për shpenzimet përkatëse, p.sh. shpenzimet e stafit për kostot e parashikuara të burimeve njerëzore, marketingun, dhe shpenzimet për buxhetet reklamuese.
- Vlerësoni nëse mbitërheqja mund të shlyhet në shtator 2019, për shembull, duke marrë dhe rishikuar parashikimin e flukseve të përgatitura për të njëjtën periudhë.
- Diskutoni me menaxhmentin arsyetimin për përdorimin e 30% të të ardhurave si bazë për përcaktimin e shpenzimeve tjera. Përveç kësaj, krahasoni këtë me rezultatet e procedurave të auditimit të kryera mbi shpenzimet për të vlerësuar nëse 30% duket të jetë një bazë e arsyeshme.

Detyra 3

Auditimi i pasqyrave financiare të Fusha Co për vitin e përfunduar më 30 nëntor 2017 është afër përfundimit dhe raporti i auditorit duhet të nënshkruhet javën e ardhshme. Fusha Co prodhon pjesë dhe komponente për industrinë e aviacionit.

Ju po kryeni një kontrolli të cilësisë për angazhimin në auditimin e Co Fusha, që është një njësi e listuar dhe një klient i ri i rëndësishëm i firmës suaj. Draft pasqyrat financiare njohin të ardhurat prej € 8.7 milion, asetet € 15.2 milion dhe fitimi para tatimit prej € 1.8 milion.

Ju keni identifikuar çështjet e mëposhtme si rezultat i shqyrtimit tuaj:

(i) Qasja e planifikuar e auditimit ndaj llogarive të pagueshme ishte të mbështetet në kontrollet e blerjes dhe të mbajtjes në minimum të testeve thelbësore. Gjatë kontrollit të testimit të të ardhurave, nga një mostër statistikore e rastësishme, grupi i auditimit ka identifikuar tre urdher-blerje të cilat nuk ishin autorizuar nga menaxheri i prokurimit. Në shqyrtimin e dokumentacioni mbështetës, ekipi i auditimit konkludoi se artikujt ishin blerjet legjitime të biznesit dhe prandaj arriti në përfundimin se nuk duhej asnjë procedurë shtesë. **(4 pikë)**

(ii) Pas një rishikimi të transaksioneve në para të imëta, ndihmësi i auditimit identifikoi se arkëtari i vogël pagoi çmimet e taksive për udhëtime personale, jo-biznesi me një vlerë totale prej 175 €. Pas diskutimeve me ndihmësin e auditimit, është konstatuar se ai nuk e ka raportuar çështjen më tej, pasi shuma është jo materiale. Ndihmësi i auditimit gjithashtu komentoi se arkëtari është vëllai i tij i vogël dhe se ai nuk donte ta bënte atë në telashe. **(6 pikë)**

(iii) Testimi i prerjes për të hyrat ka identifikuar dy urdhëra për dërgimin e mallrave, të datës 2 dhjetor 2017, për sendet e dërguara në Kina Co, me një vlerë të kombinuar të shitjes prej 17,880 € që ishin përfshirë në të ardhurat për vitin e përfunduar me 30 nëntor 2017. Kontrolluesi financiar i klientit, Guri Kavaja, ka shpjeguar se Kina Co nuk urdhëron në bazë të rregullt nga Fusha Co me mungesë të një historie të rregullt të pagesave me Kina Co prandaj, dhe për të minimizuar periudhën e mbledhjes së të arkëtueshmeve nga ky klient i veçantë, fatura e shitjes ngrihet dhe dërgohet të konsumatori në të njëjtën ditë kur merret porosia e shitjes. Periudha mesatare kohore mes marrjes së një urdhërimit dhe dërgimin e mallrave tek klienti është përafërsisht një deri në dy javë. Dokumentet e punës së auditimit kanë përfunduar se nuk është i nevojshëm hetimi i mëtejshëm. **(6 pikë)**

(iv) Drejtori i financës, Mal Kodra, nuk ka përfunduar llogaritjen e tatimeve për vitin e përfunduar më 30 nëntor 2017. Kohët e fundit ai ka kërkuar ndihmësin e auditimit të llogaris tatimin e kompanisë që paguhet për vitin pasi që kontabilisti i kompanisë i certifikuar kohët e fundit nuk ishte i përditësuar me ndryshimet e fundit në legjislacionin tatimor. **(4 pikë)**

Kërkohet:

Vlerësoni çështjet e kontrollit të cilësisë dhe implikimet për përfundimin e auditimit duke përfshirë edhe veprimet që duhet të ndërmerren nga firma juaj e auditimit. Përgjigja juaj duhet të përfshijë çështjet për të komunikuar menaxhmentit dhe atyre të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me auditimin e Fusha Co.

[Total: 20 pikë]

Zgjidhja e detyrës - 3

Vlerësimi i çështjeve të kontrollit të cilësisë, implikimet për përfundimin e auditimit dhe veprimet e mëtejshme

(i) Kontrolloni testimin e të pagueshmeve

Mungesa e dëshmisë së autorizimit nga menaxheri i prokurimit në lidhje me tre urdhërat e blerjes paraqet një përjashtim nga funksionimi efektiv i një kontrolli të brendshëm në të cilin auditori synon të mbështetet. Shqyrtimi i dokumentacionit mbështetës dhe konkluzioni se artikujt ishin shpenzime legjitime të biznesit nuk e zgjidhin përjashtimin në funksionimin efektiv të kontrollit. Ekziston rreziku që përjashtime të tjera dhe blerje të tjera të paautorizuara mund të mos kenë qenë për qëllime të ligjshme biznesi. Procedurat e auditimit prandaj duket se kanë qenë te pamjaftueshme. Asistenti i auditimit duhet ta ketë raportuar këtë çështje tek menaxheri dhe partneri për të vendosur nëse ka punë të mëtejshme ose është kërkuar analiza e rrezikut dhe kush duhet të raportohet, dmth. ata të ngarkuar me qeverisjen etj.

Para përfundimit të auditimit, ekipi i auditimit duhet të vlerësojë shkallën dhe rëndësinë e mungesës së kontrollit të brendshëm dhe duhet të konsiderojë rritjen e madhësisë së mostrës origjinale dhe zgjerimin e testimit të auditimit. Nëse testimi i zgjeruar identifikon më tej përjashtime në funksionimin efektiv të kontrollit, auditori duhet të shqyrtojë nëse një qasje e bazuar në kontroll është e përshtatshme dhe të shqyrtojë nëse kërkohen teste më thelbësore mbi përbërësin e të pagueshmeve. Në përputhje me komunikimin me SNA260 me ata të ngarkuar me qeverisje, auditori kërkohet të komunikojë gjetjet me rëndësi nga auditimi tek ata të ngarkuar me qeverisjen. Këto përfshijnë vështirësi të theksuara gjatë auditimit dhe çdo përpjekje e papritur e kërkuar për të marrë dëshmi të mjaftueshme të auditimit. Mungesa e autorizimit nga menaxheri i prokurimit në lidhje me tre urdhërat e blerjes kërkon teste të zgjeruara të auditimit dhe përfaqëson potencialisht mangësi të konsiderueshme në funksionimin e kontrolleve të brendshme. Pra, ai përfaqëson një gjetje të auditimit potencialisht të rëndësishëm që duhet t'u komunikohet atyre që janë të ngarkuar me qeverisjen.

(ii) Mashtrim me para të gatshme

Pagesa e taksive personale përfaqësojnë një transaksion mashtrues nga arkëtari dhe duhet të rishikohen në dritën e përgjegjësisë së auditorit dhe menaxhmentit në lidhje me parandalimin dhe zbulimin e mashtrimit. SNA240 Përgjegjësitë e auditorit në lidhje me mashtrimin në një auditim të pasqyrave financiare thekson se përgjegjësia primare për parandalimin dhe zbulimin e mashtrimit qëndron në personat e ngarkuar me qeverisjen e njësisë dhe menaxhmentit. Ekzistenca e mashtrimit mund të jetë edhe tregues i mëtejshëm i një mjedisi të dobët kontrolli. Auditori është përgjegjës për marrjen e sigurisë se arsyeshme se pasqyrat financiare të marra si tërësi janë të lira nga gabimet materiale, qoftë të shkaktuara nga mashtrimet ose gabim. Shuma prej 175 € është qartazi jomateriale ndaj pasqyrave financiare dhe nuk përfaqëson një burim potencial të gabimit material të shkaktuar nga mashtrimi. Auditori duhet të shqyrtojë të dhënat e parasë së gatshme për evidencë të çdo parregullsie të mëtejshme dhe të diskutojë çështjet e identifikuara me menaxhmentin.

Lidhja e asistentit të auditimit me arkëtarin paraqet një kërcënim familjar. Dështimi i asistentit të auditimit për të nxjerrë në pah çështjen para diskutimit me përgjegjës të kontrollit të kualitetit të angazhimit mund të tregojë mungesën e integritetit profesional nga ana e asistentit të auditimit. Në lidhje me SNA220 Kontrolli i Cilësisë për Auditimin e Pasqyrave Financiare, auditori, kryesisht partneri i angazhimit të auditimit, ka përgjegjësi për të monitoruar kërkesat etike gjatë gjithë procesit të auditimit. Procedurat e firmës për caktimin e personelit nepër ekipe dhe për raportimin e marrëdhënieve personale me stafin e klientëve duhet të rishikohen në dritën e kësaj përgjegjësie.

Nëse auditori konstaton se mashtrimi i parasë së imët dhe çdo çështje shtesë e identifikuar në shqyrtimin e të dhënave të parasë së imët vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut të mashtrimit dhe

kontrollit rritet, çështja duhet t'i raportohet menaxhmentit me një rekomandim që të gjithë transaksionet e parasë së imët duhet të rishikohen dhe autorizohen në mënyrë adekuate.

(iii) Testimi i prerjes mbi të ardhurat

SNRF 15 Të Ardhurat nga Kontratat me Konsumatorët kërkojnë që një njësi ekonomike të njohë të ardhurat kur ose si njësi ekonomike përmbush një detyrim të performancës duke transferuar një të mirë ose shërbim të premtuar (dmth. një pasuri) të një klient. Një pasuri transferohet kur klienti merr kontrollin e atij aktivi. Mbi këtë bazë, pra, të ardhurat janë njohur shumë herët dhe si rezultat të ardhurat, llogaritë e arkëtueshme dhe fitimet janë të ekzagjeruara.

Gabimi i identifikuar është në mënyrë të izoluar jo-material për pasqyrat financiare me 0.2% të të ardhurave (17,880 / 8.7 milion). Gabimi duhet të ekstrapolohet në bazë të rasteve të gabimeve të identifikuar dhe nivelit të shitjeve për këtë klient të veçantë në mënyrë që të vlerësohet potenciali për një gabim material. Bazuar në këtë vlerësim, auditori duhet të zgjasë testimin e prerjes në mënyrë që të vlerëson më tej potencialin për një gabim material. Auditori duhet gjithashtu të konfirmojë me menaxhmentin se procedura e faturimit është e izoluar për këtë klient të veçantë dhe e konsiderojnë zgjerimin e vlerësimit dhe testimit të tyre për çdo klient tjetër sipas nevojës.

Auditori duhet gjithashtu të shqyrtojë procedurat e prerjes së vitit të kaluar në mënyrë që të hetojë nëse ka ndonjë gabim kompensues në vitin paraprak.

Të gjitha gabimet e identifikuar duhet t'i komunikohen menaxhmentit dhe auditori duhet të kërkojë që ato të korrigjohen.

SNA260 kërkon që auditori të komunikojë me personat e ngarkuar me qeverisjen pikëpamjet e tij ose të saj për cilësinë e praktikave të rëndësishme kontabël. Mospërputhja me kriteret e njohjes i SNRF 15 paraqet një gjetje të rëndësishme nga auditimi dhe duhet t'u komunikohet atyre që janë të ngarkuar me qeverisjen sipas ISA260.

(iv) Këshilla tatimore

Siç është theksuar më lartë në (ii), auditori ka përgjegjësinë për të monitoruar kërkesat etike gjatë gjithë procesit të auditimit.

Sigurimi i ndihmës në llogaritjen e tatimit mbi të ardhurat e kompanisë që paguhet për vitin paraqet një kërcënim të vetë-shqyrtimit pasi llogaritja e tatimeve formon bazën e tatimit të pagueshëm në pasqyrën e pozicionit financiar dhe detyrimin tatimor në pasqayren e fitimit ose humbjes për vitin. Ky rrezik rritet me statusin e listës së Fusha Co dhe sipas Kodit të Etikës të BSNEK-s për Kontabilistët Profesionistë (Kodi), auditori nuk duhet të përgatisë llogaritjet tatimore për klientët e listuar. Fusha Co është një klient i listuar dhe si rrjedhim, si auditorë, firma nuk duhet të ndërmarrë asnjë shërbim tatimor si kërcënim ndaj objektivitetit të auditorit dhe pavarësisë.

Sipas SNA260, gjetjet e rëndësishme të auditimit të cilat auditori duhet të i komunikojë me personat e ngarkuar me qeverisje përfshinë çështje që, në gjykimin profesional të auditorit, janë të rëndësishme për mbikëqyrjen e financave. Auditori duhet, pra, të raportojë mungesën e aftësive dhe njohurive të përditshme të drejtorit të financave dhe të implikimeve të kësaj për procedurat e rekrutimit dhe trajnimit të klientit. Auditori duhet gjithashtu të raportojë çështjet e identifikuar më lart në lidhje me pavarësinë.

Detyra 4

Ju jeni një menaxher i auditimit në Eksperti & Co, përgjegjës për auditimin e Grupit Himara (Grupi). Ju jeni në rishikimin e dokumenteve të punës të auditimit për pasqyrat financiare të konsoliduara në

lidhje me vitin e përfunduar më 31 mars 2018. Grupi është i specializuar në furnizimin me shumicë të pllakave të çelikut dhe produkteve metalike. Projekcioni financiar i konsoliduar njihet të ardhurat prej € 7,670 milion (2017 - € 7,235 milion), fitimi para tatimit prej € 55 milion (2017 - € 80 milion) dhe asetet totale prej € 1,560 milion (2017 - € 1,275 milion). Eksperti & Co kontrollon të gjitha pasqyrat financiare individuale të kompanisë si dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit. Audituesi i lartë ka sjellë në vëmendjen tuaj çështjet, në lidhje me një numër të kompanive të Grupit:

(a) Shkodra Co

Grupi bleu 40% të kapitalit aksionar dhe të drejtave të votës në Shkodra Co më 1 maj 2017. Shkodra Co është listuar në një bursë alternative. Grupi ka fituar edhe opsione për të blerë pjesën e mbetur prej 60% të aksioneve me një zbritje prej 10% në vlerën e tregut të aksioneve në kohën e ushtrimit. Opsionet janë të ekzekutueshme për 18 muaj nga 1 maj 2018. Pasqyrat financiare të Shkodra Co për vitin që përfundon më 31 mars 2018 njohin të ardhura prej € 90 milion dhe një humbje para tatimit prej € 12 milion. Drejtori i financave i Grupit ka kontabilizuar me metoden e ekuitetit Shkodra Co në pasqyrat e këtij viti të grupit dhe ka përfshirë një humbje para tatimit prej € 4.4 milion në pasqyra e konsoliduar te fitimit ose humbjes.

(7 pikë)

(b) Prizreni Co

Prizreni Co është një degë e huaj, monedha funksionale dhe prezantuese e të cilave është e njëjtë si të Himara Co dhe pjesa e mbetur e Grupit. Filiali është i specializuar në prodhimin e çelikut inox dhe mban një portofoli domethënëse të kontratave forward të mallrave për t'i mbrojtur ndaj luhatjeve në çmimet e lëndëve të para. Juridiksioni lokal nuk urdhëron përdorimin e Standardeve të SNRF-ve dhe auditori i lartë ka vërejtur se Prizreni Co ndjek Parimet vendore pergjithesisht të pranuar të kontabilitetit, ku derivativët janë shpallur në shënimet e pasqyrave financiare por nuk njihen si aktive ose detyrime në pasqyrën e pozicionit financiar. Shënimi i shpalljes përfshin detajet e maturimit dhe termat e opsioneve dhe vlerësimin e drejtorëve duke deklaruar se ata kanë një vlerë të drejtë të plotë prej € 6.1 milion si në 31 mars 2018. Shënimi shpjegues thekson se të gjitha kontratat derivative janë lidhur në tre muajte e fundit të periudhës raportuese dhe se nuk kërkonin investime fillestare neto.

(6 pikë)

(c) Peja Co

Peja Co është një degë e vjetër në të cilën prindi i Grupit ka një zotërim të drejtpërdrejtë prej 80% të kapitalit dhe të drejtat e votimit. Puna e auditimit mbi të ardhurat dhe të arkëtueshmet në Peja Co ka identifikuar shitjet e aluminit tek kompania prind i saj në mars 2018 me një vlerë totale të shitjes prej € 77 milion të cilat janë regjistruar në pasqyrat financiare të filialit. Procedurat e auditimit kanë identifikuar, megjithatë, se marrja e aluminit nuk është regjistruar nga shoqëria mëmë deri më 2 prill 2018. Grupi nuk ka bërë asnjë rregullim për këtë transaksion në draft pasqyrat financiare të konsoliduara. Peja Co realizon margjine të fitimit 10% në të gjitha shitjet e saj të aluminit.

(7 pikë)

Kërkohet:

Komentoni çështjet që duhet të konsiderohen dhe shpjegoni provat e auditimit që duhet të prisni të gjeni gjatë kohës tuaj në rishikimin e dokumenteve të punës të auditimit të Grupit në lidhje me secilën prej çështjeve të përshkruara më sipër.

Zgjidhja e detyrës - 4

(a) Shkodra Co

Çështjet

Çështja kryesore që duhet marrë parasysh është statusi i investimit në Shkodra Co në pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit. Megjithëse mbajtja prej 40% bie brenda intervalit të zakonshëm për një pjesëmarrje sipas SNK 28 Investimet në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta, ekzistenca e opsioneve të aksioneve në pjesën e mbetur prej 60% është tregues i kontrollit sipas SNRF 10 Pasqyrat Financiare të Konsoliduara. SNRF 10 përmban udhëzime specifike për situatat ku kontrolli mund të ekzistojë kur investitori nuk mban shumicën e të drejtave të votës. Sipas SNRF 10, kontrolli dhe si rrjedhim statusi si një filiali mund të bazohet në të drejtat potenciale të votimit me kusht që të drejtat e tilla janë thelbësore. Në rastin e Shkodra Co, potenciali që të drejtat e votimit mund të ushtrohen në të ardhmen e afërt (brenda një muaji nga data e raportimit) dhe 10% zbritje në çmimin e tregut, i bën ato tërheqëse komerciale për Grupin. Opsionet përfaqësojnë kështu të drejtat substanciale të votimit potencial dhe pasqyara e fitimit ose humbjes e Shkodra Co duhet të konsolidohet që nga data e blerjes. 40% në Shkodra Co është mbajtur për 11 muaj të periudhës raportuese aktuale. Të ardhurat janë materiale për pasqyrat financiare të konsoliduara në € 82.5 milion (€ 90 milion x 11/12) 1.1%. Në të njëjtën bazë, humbja para tatimit është € 11 milion (€ 12 milion x 11/12) e cila është € 6.6 milion më e madhe se humbja e njohur sipas metodës së kapitalit prej € 4.4 milion. Diferenca është gjithashtu materiale për pasqyrat financiare me 12% të fitimit të Grupit para tatimit. Duke pasur parasysh statusin e humbjes së Shkodra Co, ka një nxitje për të mos konsoliduar njësinë ekonomike. Auditori duhet ushtrojnë skepticizëm profesional dhe shqyrtojë nëse ka ndonjë implikim në lidhje me integritetin e menaxhmentit.

Dëshmi

- një kopje të dokumenteve ligjore që mbështesin blerjen e aksioneve dhe opsionet duke përfshirë të drejtat e votimit dhe kushtet e ushtrimit të opsioneve.
- Një përmbledhje të dokumenteve të punës të auditimit për Shkodra Co, duke përfshirë detajet e kapitalit aksionar të emetuar dhe të drejtat votimin të lidhura me aksionet.
- Procesverbalet e bordit të grupit në lidhje me blerjen dhe qëllimet e menaxhmentit në lidhje me Shkodra Co.
- Përfaqësime me shkrim nga menaxhmenti mbi shkallën e ndikimit të ushtruar mbi Shkodra Co dhe synimet e ardhshme në lidhje me opsionet e aksioneve.

(b) Prizreni Co

Çështjet

Vlera e drejtë e derivativëve prej € 1.000.000 është material për fitimin e konsoliduar para tatimit në 11.1%, por në mënyrë të izoluar, janë jomateriale ndaj aktiveve të konsoliduara në 0,4%.

SNRF 9 Instrumentet Financiare kërkon njohjen e derivativave në pasqyrën e pozicionit financiar me vlerën e drejtë në fitimet dhe humbjet e njohura për periudhën. Prandaj, vlera e drejtë prej € 1.000.000 duhet të përfshihet në aktivitetet aktuale në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar të Grupit dhe duke pasur parasysh se opsionet kanë hyrë në tre muajt e fundit të periudhës pa asnjë investim fillestar neto, duhet të jetë gjithashtu një fitim me vlerë të drejtë prej € 1.000.000 i regjistruara në pasqyrën e konsoliduar të fitimit ose humbjes për vitin. Trajtimi i derivateve sipas PPPK-ve vendore është i

pranueshem në pasqyrat financiare individuale të entitetit Prizreni Co. Megjithatë, për qëllime Grupi duhet të jenë në përputhje me politikat kontabël dhe fitimi para tatimit në projekt-pasqyrat financiare të konsoliduara është materialisht i nënvlerësuar.

Auditori duhet gjithashtu të ushtrojë skepticizëm profesional në lidhje me ate nese drejtorët kanë ekspertizën e kërkuar për të vlerësuar derivativet dhe duhet të konsiderojnë nevojën për dëshmi të pavarura dhe të jashtme të vlerës së drejtë të opsioneve në datën e raportim.

Dëshmi

- Detajet e vlerës së drejtë të opsioneve bazuar në çmimet që rrjedhin nga një treg aktiv ose nëse kjo nuk është në dispozicion, nje vlerësimi i ekspertëve të pavarur.
- Dokumentacioni i auditimit të rishikimit të kontratave te derivative dhe konfirmimi i afateve të maturimit.
- Shënimet e një diskutimi me menaxhmentin në lidhje me bazën e vlerësimit të tyre dhe trajtimin kontabël të kërkuar në pasqyrat financiare të konsoliduara.

(c) Peja Co

Çështjet

Pasqyrat financiare të konsoliduara përgatiten nga perspektiva e grupit dhe transaksionet brenda grupit dhe balancat duhet të eliminohen në konsolidim. Vlera e shitjes prej € 77 milion është materiale me 1% të të ardhurave të konsoliduara dhe 4,9% të aseteve te konsoliduara.

Fitimi i parealizuar prej € 7.7 milion (77 milion € × 10%) është gjithashtu material për fitimin e konsoliduar para tatimit për vitin në 14% (€ 7.7 milion / € 55 milion). Të ardhurat e Grupit, llogaritë e arkëtueshme dhe fitimi para tatimit janë pra të ekzagjeruara materialisht. Transaksionet duhet të verifikohen në regjistrimet e kontabilitetit të subjekteve individuale për të konfirmuar që Peja Co ka përfshirë shitjen në financat e saj dhe se shoqëria mëmë nuk e ka përfshirë blerjen në pasqyrat e saj financiare. Megjithatë, duke pasur parasysh se mallrat janë ende në tranzit në datën e raportimit, inventari i grupit do të nënvlerësohet nga € 69.3 milion (€ 77m × 90%) që është gjithashtu materiale për aktivet e grupit në 4,4%. Fitimet e pashpërndara të konsoliduara do të mbivlerësohen me € 6.16 milion (€ 7.7 milion × 80%) dhe interesat jo-kontrolluese do të mbivlerësohen nga € 5.4mil (€ 7.7 milion × 20%). Kontabilizimi për transaksionin brenda pasqyrave financiare individuale të entitetit gjithashtu do të keqpërdoret.

Dështimia për të identifikuar transaksionin e tregtimit brenda grupit tregon një mangësi në kontrollin e brendshëm brenda grupit dhe për këtë arsye rreziku i kontrollit eshte i rritur për auditimin e pasqyrave financiare të konsoliduara.

Dëshmi

- Marrëveshja e transaksionit me dokumentet themelore siç janë faturat e shitjes, shënimet e dërgimit të mallrave në Peja Co dhe fatura te blerjes në kompaninë e saj mëmë.
- Kostoja e inventarit në transit duhet të ishte konfirmuar në të dhënat e prodhimit në Peja Co për të konfirmuar 10% marzh fitimi.
- Një kopje të mallit të marrë te datës 2 prill 2018 të ngritur nga kompania amë konfirmuar detajet e inventarit në tranzit dhe transaksioni që regjistrohet në inventar dhe në librin e blerjes pas përfundimit të vitit.
- Një kopje e faturës së shitjeve u përcillet në librin e shitjeve të Peja Co duke rënë dakord detajet e vlerës së shitjes.

- Rregullimet e kërkuara për të eliminuar transaksionin duhet të shënohen në një tabelë të gabimeve të pasqyruara për diskutim me klientin.

Detyra 5

(a) SNA 701 Komunikimi i Çështjeve Kryesore të Auditimit në Raportin e Auditorit të Pavarur thotë 'Qëllimi i Komunikimi i çështjeve kyçe të auditimit është të rrisë vlerën komunikuese të raportit të auditorit duke siguruar transparencë më të madhe në lidhje me auditimin që është kryer. '

Kërkohe:

Diskutoni këtë deklaratë në lidhje me përfitimet dhe vështirësitë e komunikimit të çështjeve kyçe të auditimit tek përdoruesit të raportit të auditorit dhe kontributin e SNA 701 në adresimin e hendekut të pritjes së auditimit. (8 pikë)

(b) Ju jeni menaxher përgjegjës për auditimin e Grupit Gjilani (Grupi), një prodhues i listuar i instrumenteve muzikore me cilësi të lartë, për vitin e përfunduar më 31 mars 2018. Draft pasqyrat financiare të Grupit njohin një humbje para tatimit prej € 2.2 milion (2017 - humbje prej € 1.5 milion) dhe totalit të aktiveve prej € 14.1 milion (2017 - € 18.3 milion). Auditimi është afër përfundimit dhe audituesi i lartë ka hartuar raportin e auditorit i cili përmban ekstraktin e mëposhtëm:

Çështjet kryesore të auditimit**1. Vlerësimi i instrumenteve financiare**

Grupi hyn në kontrata të strukturuaruara foruad për blerjen e materialeve të përdorura në procesin e prodhimit. Vlerësimi i këtyre instrumenteve përfshin sypozime dhe bazohet në modelet e brendshme të zhvilluara nga drejtori i financës i Grupit, Elbasan Ferizaji. Z. Elbasan Ferizaji u bashkua me Grupin në janar 2018 dhe ka rëndësi pasiguria e matjes e përfshirë në vlerësimet e tij si rezultat i mungesës së eksperiencës së tij. Si rezultat, vlerësimet e këtyre kontratave ishin të rëndësishme për auditimin tonë.

2. Likuidimi i klientit

Në llogaritë e arkëtueshme të paraqitura në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar është përfshir një shumë prej € 287,253 nga një klient i cili ka ndërprerë tregtimin. Në bazë të asaj se Grupi nuk ka siguri për këtë borxh, ne besojmë se Grupi duhet të bëjë një provizion të plotë për zhvlerësim prej € 287,253 duke reduktuar fitimin përpara tatimit për vitin dhe asetet e përgjithshme më 31 mars 2018 për atë shumë. Opinioni i kualifikuar që rrjedh nga mosmarrëveshjet në lidhje me trajtimin kontabël sipas mendimit tonë, përveç efektit në pasqyrat financiare të çështjes së përshkruar më sipër, pasqyrat financiare janë përgatitur siç duhet në të gjitha aspektet materiale në përputhje me Standardet e SNRF.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen për humbjen para tatimit prej € 2.2 milion për vitin e përfunduar më 31 mars 2018 dhe që Grupi është në shkelje të zotimeve të huasë me ofruesit e saj financiarë kryesorë. Prandaj ekziston një pasiguri materiale e cila mund të hedh dyshime mbi aftësinë e Grupit për të vazhduar me parimin e vazhdimesisë. Opinioni ynë nuk është ndryshuar për këtë çështje.

Kërkohe:

Vlerësoni në mënyrë kritike ekstraktin nga raporti i auditorit për pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit Gjilani për vitin që përfundon më 31 mars 2018. (12 pikë)

[Total: 20 pikë]

Zgjidhja e detyrës - 5

(a) Çështjet kryesore të auditimit janë çështjet të cilat, në gjykimin e auditorit, kanë qenë me rëndësi të madhe në auditimin e pasqyrave financiare. Ato u prezantuan nga SNA701 Komunikimi i Çështjeve Kryesore të Auditimit (CKA), për të përmirësuar raportin e auditorit të lëshuar në lidhje me subjektet e listuara, duke ofruar informata më të rëndësishme për përdoruesit e këtyre raporteve.

Arsyeja kryesore për dhënien e informacioneve shpjeguese në raportin e auditorit ishte sigurimi i transparencës.

Hendeku i pritjes së auditimit është dallimi në mes të rolit aktual të auditorit të jashtëm dhe rolit që publiku beson se auditori ka. Në këtë kontekst, përfshirja e ceshtjeve në raportin e auditorit paraqet një hap të rëndësishëm në procesin e informimit dhe edukimit të publikut për rolin e auditorit në vlerësimin e fushave me rrezik të lartë, gjykimet dhe ngjarje apo transaksione të rëndësishme që ndodhën gjatë periudhës.

Përcaktimi i auditimit i cili duhet të raportohet si 'kyç' është subjektiv dhe kërkon gjykimin e auditorit. Si rezultat, kjo mundet të reduktojë konsistencën dhe krahasueshmërinë e raportimit të auditorit. Për të ndihmuar me këtë, SNA701 ofron një vendim-marrje kornizë për të ndihmuar audituesit të përcaktojnë cilat çështje janë kyçe. Kjo duhet të ndihmojë në uljen e dykuptimësisë dhe në promovimin e qëndrueshmërisë në të gjitha auditimet.

Përfshirja e ceshtjeve kyçe në raportin e auditorit mund të çojë në një rritje të konsiderueshme të vëllimit të detajeve të përfshira në raport. Kjo rritje në volum mund të pengojë përdoruesit në leximin e raportit të auditorit në mënyrë të plotë dhe për rrjedhojë zvogelojnë rolin e raportit në mbylljen e hendekut të pritjes së auditimit. Ka gjithashtu shqetësime se mungesa e udhëzimeve specifike mund të çojë në dhënien e informacioneve të standartizuara të cilat shtojnë pak vlerë në raportin e auditorit.

(b) Ekzistojnë një sërë çështjesh që duhet të merren parasysh në vlerësimin kritik të ekstraktit të raportit të auditorit i cili është hartuar nga auditimi i lartë. Këto përfshijnë si në vijim:

Çështjet kryesore të auditimit (CKA)

Seksioni duhet të përfshijë një paragraf hyrës që shpjegon konceptin e CKA-së në mënyrë që përdoruesit e raportit të auditorit të kuptojnë rëndësinë. Prezantimi gjithashtu duhet të theksojë qartë se auditori nuk është duke formuar një opinion të veçantë mbi pikat e identifikuara si CKA.

Vlerësimi i instrumenteve financiare

Kjo është një fushë e vlerësimit të rëndësishëm të auditimit me një rrezik të lartë të gabimeve materiale, prandaj përfshirja si CKA është e përshtatshme edhe duhet të shpjegojë faktorët që çuan auditorin të përcaktonte çështjen si CKA.

Auditori duhet të përshkruajë se si është adresuar CKA në auditim dhe megjithëse kjo është çështje për gjykimin e auditorit, auditori mund të përshkruajë aspektet e përgjigjes ose qasjes së auditorit, të sigurojë një pasqyrë të shkurtër të procedurave të kryera dhe një tregues të rezultatit të procedurave. Bazuar në formulimin aktual, përdoruesit e raportit të auditorit nuk do të kishin tregues të qartë se si auditori ka mbledhur dëshmi mbi këtë fushë kyçe.

Ka edhe disa çështje në lidhje me hartimin e hollësishëm të paragrafit. Raporti nuk duhet t'i referohet drejtorit financiar të grupit me emër dhe nuk duhet të nënkuptojë kritika ndaj tij si rezultat i mungesës së eksperiencës së tij. Përdorimi i fjalës 'supozim' është i papërshtatshëm dhe zvogelon besueshmërinë e procesit të auditimit dhe raportimit financiar.

Likuidimi i klientit

Shuma e borxhit nga klienti prej € 287,253 është material për humbjen para tatimit në 13,1% dhe tek asetet në 2%. Megjithatë, detajet e keq-deklarimit materialit nuk duhet të përfshihen në seksionin e CKA por duhet të jepen në bazë të paragrafit të opinionit të kualifikuar.

Kjo gjithashtu duhet të tregohet qartë në referencën brenda vetë paragrafit të opinionit.

Paragrafi i opinionit

Kjo është e pozicionuar gabimisht dhe titullohet gabimisht. Duhet të jetë në fillim të raportit të auditorit dhe thjesht duhet të titullohet 'Opinion i Kualifikuar'. Paragrafi i opinionit duhet të jetë tërësisht i referuar në paragrafin e "Bazës për Opinionin e Kualifikuar" i cili duhet të vendoset menjëherë nën paragrafin e opinionit dhe duhet të përshkruajë qartë çështjen që ka ngritur një opinion të kualifikuar. Si më sipër, kualifikimi "përveç" për shkak të materialitetit është i përshtatshëm.

Theksi i çështjes

Sipas SNA570 Parimi i vazhdimësisë, theksimi në pasqyrat financiare nuk është më i përshtatshëm. Raporti i auditorit tani duhet të përfshijë një seksion specifik të titulluar 'Pasiguria materiale lidhur me parimin e vazhdimësisë' menjëherë pas bazës për paragrafin e opinionit. Pasiguria materiale lidhur me vazhdimësinë e biznesit duhet të kalojë qartë në shënimin shpjegues ku drejtorët kanë dhënë detaje të pasigurisë. Nëse çështja nuk është shpalosur në mënyrë adekuate nga drejtorët në pasqyrat financiare, auditori duhet të japë detaje të plota për pasiguritë në lidhje me vazhdimësinë e biznesit dhe opinionin duhet të jetë i kualifikuar "me përjashtim të" gabimeve materiale në lidhje me këtë mungesë të zbulimit.